



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Datë 06.04.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbim
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime riparimi, mirëmbajtje automjeteve dhe pjesë këmbimi për vitin 2023”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

34330000-9 Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash
50112000-3 Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash
50114100-8 Shërbime riparimi për kamion
50116000-1 Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje për pjesë specifike automjeteve

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 731 000 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kuafi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar ekspriencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori/et ekonomik duhet të disponojë brenda territorit të Bashkisë Përmet minimumi një ambient pune (servis/oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve për të gjitha llojet e mjeteve sipas specifikimeve teknike në funksion të realizimit të kontratës. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose nëse e ka me qira, kontratën e qirasë të objektit në vendodhjen e sipërpërmendur ose kontratë bashkëpunimi me biznes që ka pikë shërbimi në qytetin e Përmetit.

Shënim: Në zbatim të pikës 6, Neni 26, të VKM-së Nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3.2 do të dorëzohet pranë AK, brenda 5 ditëve nga njoftimi për ti dorëzuar por në çdo rast përpara shpalljes së njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mënyrë që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme organizative, për të zbatuar dhe për të përmbushur kontratën në përputhje me specifikimet dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe nisur nga shumëllojshmëria e mjeteve, specifikat e veçanta të tyre dhe numri i mjeteve për mirëmbajtje. Autoriteti kontraktor kërkon që operatorit të ketë në pronësi ose me qira një servis që të krijojë bindjen se ky i fundit do të kryejë shërbimin e kërkuar në kohën e duhur.

2.3.3 Operatori/et ekonomik duhet të deklarojë se Garancia e pjesëve të këmbimit që do të përdoren gjatë riparimit të automjeteve kërkohet të jetë jo më pak se 6 muaj nga data e daljes së mjetit nga riparimi. Gjatë kësaj periudhe të garantojë **pa pagesë** riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin që do kryejë.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 6 muaj garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet, që ka në dispozicion, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe do të vërë në dispozicion **pa pagesë** automjet të specializuar për transportin e automjeteve të difektuara, si me poshtë:

Nr.	Emri i mjetit	Sasia	Statusi
1	Automjet Karrotrec	1 copë	Në pronësi ose me qera

- Për këtë të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (Certifikatë e pronësisë, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit taksën vjetore (të vlefshme).
- Në rastin e marrjes me qira, dokumentacioni i mësipërm të shoqërohet me kontratë noteriale të qirasë të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, dhe është vlerësuar e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht **pajisjet/karrotrec** për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtje e automjeteve, mund të ndodh që në raste defekti i cili shkakton teknikisht pamundësinë e lëvizjes vetë të automjeteve OE duhet të transportojë një automjet të difektuar në ambjentet e servisit që disponon **pa pagesë**.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.74 datë 17.02.2023, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Përmet, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Përmet disponon 11 automjete transporti, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga veturat, kamionçinat, kamionë me akse të ndryshme, automjete të transportit të veçantë, të stacionuar për shërbime të ndryshme. Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat që ka çdo mjet sipas tipologjisë, vitit të prodhimit, kilometrave të përshkuara dhe/ose orëve të punës, me qëllim dhënien e një informacioni sa më të plotë për çdo mjet me qëllim kryerjen dhe sigurimin e një shërbimi cilësor të mjeteve të AK-së.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 18.04.2023, ora 12:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Shërbime riparimi, mirëmbajtje automjeteve dhe pjesë këmbimi për vitin 2023”.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

- Dokumentat e tenderit.
- Preventiv

NJËSIA E PROKURIMIT

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA